

**Na lejoni t'ju
ndihmojmë!**

**Avokati i Tatimpaguesit
ka për mision të mbrojë
interesat e tatimpaguesit
në marrëdhëniet me
organet tatimore
nëpërmjet zgjidhjes së
kërkesave/ankesave të
paraqitura nga
tatimpaguesit.**

Kontakt

Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3
Tiranë, Shqipëri
avokati.tatimpaguesit@financa.gov.al

Orari zyrtar

Nga e hëna deri të enjten: 08:00 - 16:30
Të premten: 08:00 - 14:00
(përveç ditëve të festave zyrtare)



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E FINANCAVE

Avokati i Tatimpaguesit



Parimet që udhëheqin Avokatin e Tatimpaguesit

Avokati i Tatimpaguesit, në ushtrimin e funksioneve dhe detyrave të tij në mbrojtje të të drejtave të tatimpaguesit, udhëhiqet kryesisht, por pa u kufizuar,

- nga parimet e:
- ligjshmërisë;
 - paanësisë;
 - konfidencialitetit;
 - profesionalizmit.

Përse mund t'i drejtoheni Avokatit të Tatimpaguesit

Çdo tatimpagues, grup tatimpaguesish, apo shoqatë biznesi, mund t'i drejtohet Avokatit të Tatimpaguesit kur pretendon se u cënohen të drejtat tatimpaguesve të veçantë apo një grupi tatimpaguesish, nga veprime ose mosveprime të administratës tatimore, apo sjellje e punonjësve të veçantë të administratës tatimore, të tilla si në:

- administrimin e tatimeve, si vonesa administrative të paarsyeshme apo gabime të zyrtarëve tatimorë, që nuk janë zgjidhur në mënyrën e duhur nga administrata tatimore pas paraqitjes së ankesës nga tatimpaguesi;
- mosrespektimin e procedurave tatimore apo shkeljes së procedurave tatimore nga zyrtarët tatimorë;
- mosdhënien e informacioneve të kërkuara, përsa lejohet nga legjislacioni tatimor;
- moslëshimin e vërtetimeve nga organi tatimor, kur kërkohen nga tatimpaguesi;
- mosofrimin e asistencës së kërkuar lidhur me legjislacionin tatimor dhe që lidhen me detyrimet e tatimpaguesit, kur ai ka paqartësi në njohjen dhe zbatimin e tij;
- sjellje që cënojnë, denigrojnë apo fyejnë tatimpaguesin.

Çdo vendim për të ndërmarrë masat korrigjuese i takon administratës tatimore dhe jo Avokatit të Tatimpaguesit. Në rast se nuk gjendet zgjidhje për një çështje të caktuar, Avokati i Tatimpaguesit gëzon të drejtën ta ngrejë nivelin e verifikimit dhe të investigimit deri në nivelin më të lartë të drejtimit të administratës tatimore, që është Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

Ankesat që nuk mund t'i shqyrtojmë

Janë jashtë kompetencës së Avokatit të Tatimpaguesit, kërkesat që lidhen me:

- trajtimin e rasteve që lidhen me një vlerësim tatimor, përveç kur janë zbatuar gabim procedurat që lidhen me këtë vlerësim;
- trajtimin e rasteve që janë nën hetim tatimor.

Baza ligjore

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 648, datë 28.07.2010, "Për avokatin e tatimpaguesit", i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 6, datë 25.02.2019, "Për funksionet, autoritetin dhe përgjegjësitë e Avokatit të Tatimpaguesve, procedurat që do të zbatohen prej tij në mbrojtje të interesave të tatimpaguesve, si dhe procedurat që duhet të ndiqen nga tatimpaguesit, për të përfituar mbrojtjen e të drejtave të tyre nga avokati i tatimpaguesve", i ndryshuar;
- Manuali Procedural i Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesve, datë 25.02.2019

